




In medias res

Formulimi i Vizionit (3)

“Të mësuarit është pjesë e të jetuarit, prandaj përvoja e jetës duhet të jetë bosht i kurikut”

Pasi i kemi dhënë disa vizione të qëllimeve të ndryshme arsimore në nivelet nacionale, atëherë duhet të merrem edhe pak me përcaktimin e vizioneve në kurikulat lëndor. Po para se të përmendim disa shembuj të formulimeve të vizioneve kurrikulare lëndore duhet të përcaktojmë dhe një kronologji të zërthimi të Vizionit arsimor nacional në vizionin të kurrikulit lëndor (skema 1)



Përshkrimi i aktiviteteve sipas programeve

Programi i granteve për zhvillimin e shkollave

■ Gjatë muajit qershor, bashkëpunëtorët profesional të terrenit kanë ndihmuar 114 shkollat përfituese të rundit të parë që të respektojnë procedurat e prokurimit dhe të kompletojnë dokumentet e nevojshme, si parakusht për të marrë aprovimin nga Ekipi Koordinues i Projektit në MASHT për nënshkrimin e kontratave me kompanitë fituese. Si rezultat i punës së BPT shumë shkolla kanë arritur që të nënshkruajnë kontratat me kompanitë përfituese dhe të pranojnë mallrat dhe shërbimet e kontraktuara.



Shkolla "Z.L.Marku" në Brekoc

■ Po ashtu, BPT gjatë muajit qershor kanë ndihmuar disa shkolla të rundit të dytë në përgatitjen e planeve zhvillimore të tyre dhe projekt propozimeve. Pritet që shkollat që nuk kanë përfunduar me finalizimin e PZhSh dhe projekteve të tyre ta bëjnë këtë në fillim të shtatorit, pas kthimit të mësimdhënësve nga pushimi veror.

KOSOVISION Contest

■ Me datën 11 qershor 2011 në Pallatin e Rinisë u mbajt ceremonia e ndarjes së shpërblimeve, aktivitet ky i cili e përmbylli rrugën trevjeçare të projektit. Në këtë ceremoni ishin ë ftuar në rreth 500 pjesëmarrës. Të gjitha klasat fituese të fazës së dytë i morën shpërblimet. Më saktësisht nga 85 klasa pjesëmarrëse në projekt u shpërblyen 24 prej tyre.



Edhe pse ky ishte aktiviteti përmbyllës i projektit, stafi i projektit është duke hulumtuar për mundësinë e vazhdimit të projektit edhe në vitet e ardhshme.




Promovimi i të drejtave të fëmijës në fushën e arsimit

■ Në kuadër të projektit "Promovimi i të drejtave të fëmijës në fushën e edukimit", financuar nga Zyra Ndërlidhëse

e Komisionit Evropian në Kosovë, gjatë këtij muaji janë zhvilluar këto aktivitete:

- Është përfunduar raporti i dytë i monitorimit. Raporti është përkthyer edhe në gjuhën serbe dhe angleze.
- Raporti është botuar dhe është bërë gati për diskutim publik dhe për shpërndarje tek palët e përfshira.



- Kanë filluar përgatitjet për ceremoninë e diskutimit publik të raportit, njëkohësisht kjo ngjarje do të përmbyll këtë projekt.

Parandalimi i dhunës në shkolla

- Gjatë këtij muaji ekipi i projektit ka zhvilluar vizita të shumta në terren. Qëllimi i këtyre vizitave është për të

shikuar nga afër gjendjen e sigurisë në shkollat tona.

Ekipi i projektit është duke i shkruar raportet e monitorimit. Për secilën shkollë të vizituar, do të shkruhet një raport për gjendjen. Raporti do të jetë i pasqyruar me fotografi, dhe do të përmbaj rekomandime apo hapat që duhet ndërmarrë nga udhëheqësit e shkollës dhe ata të DKA-së përkatëse.

Gjatë këtij muaji shumica e Komiteteve Komunale dhe Rajonale kanë dërguar raportet për punën e tyre. Ky proces pritet të përmbyllet deri me 15 korrik.

Qasja Tërësektoriale në Arsim – EU EDUCATION SWAp

- Projekti Qasja Tërësektoriale në Arsim - EU EDUCATION SWAp ka filluar të implementohet në muajin tetor të vitit 2009. Ky projekt financohet nga Komisioni Evropian dhe menaxhohet nga Zyra Ndërlidhëse e Komisionit Evropian në Kosovë.

Projekti implementohet nga konsorciumi i përbërë nga Cambridge Education, Qendra për Arsim e Kosovës, Education 2000+ Consulting dhe Tribal Helm.

- Gjatë muajit qershor Projekti u angazhua në avancimin e të kuptuarit të stafit të lartë të MASHT-it për qasjen tërësektoriale (SWAp), veçanërisht në lidhje me Planin Strategjik të Arsimit në Kosovë (PSAK), i cili paraqet planet e MASHT-it për periudhën 2011-2016. Gjithashtu projekti u angazhua në diskutime për përmirësimin e koordinimit mes donatorëve – kjo është një nga qëllimet kryesore të projektit. Udhëheqësi i Ekipit të Projektit informoi donatorët për planet e mbajtjes së punëtorisë për Rishikimin e Përbashkët Vjetor të sektorit, që do të mbahet në muajt në vijim. Kjo ngjarje do t'i ofrojë mundësi MASHT-it,

ministrive dhe akterëve tjerë, përfshirë donatorët, për rishikimin e progresit të PSAK-ut. Përveç kësaj, Projekti mori pjesë në grupet punuese nën-sektoriale për arsim parauniversitar dhe për arsim të lartë, të formuara nga Ministria për Integritim Evropian nën ombrellën e një grupi punues për Edukim dhe Punësim.

■ Në kuadër të aktiviteteve të komponentit të dytë të projektit gjatë muajit qershor janë përgatitur dhe shpërndarë pyetësorë në një numër shkollash të niveleve dhe llojeve të ndryshme përfshirë nivelin fillor, të mesëm të ulët dhe të mesëm të lartë të përgjithshëm dhe profesional. Qëllim i këtij aktiviteti ka qenë grumbullimi i sa më shumë informacioneve në lidhje me përparësitë dhe mangësitë e planë-programeve ekzistuese. Në kuadër të këtij aktiviteti janë organizuar edhe takime me grupe fokusi me mësimdhënës të një shkolle të mesme profesionale dhe me mësimdhënës të nivelit fillor, takime të ngjashme do të vazhdojnë të organizohen edhe gjatë gjysmës së dytë të muajit gusht. Pos kësaj, projekti ka vazhduar të mbështesë zhvillimin e Rezultateve Mësimore Esenciale (RME) për shkallë të kurrikulumit si dhe zhvillimin e udhëzuesve për mësimdhënës dhe drejtor të shkollave, udhëzues të cilët do të ndihmojnë në modernizimin e praktikës së mësimdhënies në linjë me praktikën më të mira në Bashkimin Evropian.

■ Gjatë këtij muaji projekti ka bashkëpunuar me Departamentin e MASHT-it për Arsim të Lartë dhe me Zyrën e Rektorit të Universitetit të Prishtinës në zhvillimin e një deklarate të përbashkët (manifesti) për strukturën e ardhshme të Fakultetit të Edukimit. Pos kësaj, Projekti është duke ndihmuar Fakultetin e Edukimit në planifikimin dhe organizimin e një konference ndërkombëtare dyditore e cila do të mbahet në muajin tetor. Projekti vazhdon të mbështesë Këshillin Shtetëror për

Licencim të Mësimdhënësve, veçanërisht në zhvillimin e Profilit të Kompetencave të Mësimdhënësve.

Mbështetje e BE-së për Zbatimin e Strategjisë për komunitetet Rom, Ashkali dhe Egjiptas (EU-SIMRAES)

■ Në kuadër të projektit “Mbështetje e BE-së për Zbatimin e Strategjisë për komunitetet Rom, Ashkali dhe Egjiptas”, financuar nga Zyra Ndërlidhëse e Komisionit Evropian në Kosovë, gjatë këtij muaji janë zhvilluar këto aktivitete:

■ Edhe në këtë muaj në mënyrë rregullt ka shkuar mbarëvajtja e aktiviteteve në qendrat mësimore. Duhet të theksohet se gjatë muajit maj dhe në fillim të muajit qershor qendrat kanë angazhuar trajner për ofrimin e ndihmës për nxënësit që do t'i nënshtrohen provimit të maturës, testit të arritshmërisë si dhe provimit pranues në institucionet e larta arsimore.



Qendra Mësimore në Graçanicë

■ Gjatë këtij muaji janë zhvilluar monitorimet në secilën qendër sipas planit dhe në shumicën e qendrave janë dhënë komente pozitive. Gjatë muajve në vijim do t'iu kushtohet më shumë vëmendje dhe do t'iu ofrohet ndihmë shtesë nga stafi i projektit EU SIMRAES qendrës Terzi

Mahalla në Prizren dhe qendrës mësimore Roma Mahalla në Mitrovicë me qëllim të përmbushjes së të gjithë standardeve dhe rekomandimeve të dhëna nga monitoruesit e qendrave.

■ Aktiviteti i bursave për nxënës dhe student është duke shkuar sipas planit ende janë duke u sjellë dhe shqyrtuar dokumentacionet e kërkuara nga KEC nga të gjithë bursistët. Deri më tani nuk është hasur në ndonjë problem.

Në qershor lirisht mund të thuhet se të gjitha qendrat janë të pajisura me çdo pajisje dhe material të nevojshëm didaktik dhe tanimë posedojnë të gjitha kushtet për mbarëvajtje normale të aktiviteteve dhe procesit mësimor.

Përgatiti: Petrit Tahiri